

## **KLSH merr pjesë në konferencën për “Matjen e Performancës Mjedisore në Sektorin Publik”**

Më 6 shkurt 2025, Gjykata Franceze e Llogarive (Cour des Comptes) organizoi konferencën me temë “Matja e Performancës Mjedisore në Sektorin Publik”. Aktiviteti u hap nga Presidenti i Parë, z.Pierre Moscovici dhe përfshiu ekspertë francezë dhe ndërkombëtarë, drejtues të administratës publike, zyrtarë dhe përfaqësues të autoriteteve lokale.



Në këtë aktivitet u zhvilluan katër diskutime në tryeza të rumbullakëta, ku u trajtuan temat e mëposhtme:

1. Prezantimi i koncepteve të Kontabilitetit Mjedisor: Ky diskutim eksploroqi qasjet makroekonomike dhe analizoi ngjashmëritë dhe dallimet ndërkombëtare në kontabilitetin mjedisor.
2. Mjetet e Kontabilitetit Mjedisor: Pjesëmarrësit ndanë shembuj të zbatimit të kontabilitetit mjedisor në organizatat publike, duke evidentuar sfidat dhe përfitimet praktike.
3. Shembuj të Buxhetimit të Gjelbër në Sektorin Publik: Ky seksion analizoi metodologjitë, sukseset dhe kufizimet e nismave të buxhetimit të gjelbër, duke ofruar njohuri mbi praktikatat më të mira.
4. Raportimi i Qëndrueshmërisë Jo-Financiare në Sektorin Publik: Diskutimi i fundit shqyrtoi mundësinë e përshtatjes së standardeve të raportimit nga sektori privat për sektorin publik, duke debatuar për përfitimet dhe sfidat e mundshme.

Të pranishmit ndanë njohuritë dhe përvojat e tyre në matjen dhe përmirësimin e performancës mjedisore në sektorin publik, duke ofruar perspektiva të ndryshme nga kontekste të ndryshme ndërkombëtare. Në këtë aktivitet KLSH u përfaqësua nga znj.Xhesika Xhuveli, znj.Joana Troqe dhe znj.Arminda Bushi.